

Prot. 2211/218 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: Partia Bindja Demokratike

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin

financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin BD, KRIIK ka konstatuar se:*

- *evidentohet një numër prej 5 zyrash zgjedhore të padeklaruara;*
- *partia ka deklaruar pranimin e 8 dhurimeve në vlerë më të madhe së 50.000 lekë, jo nëpërmjet llogarisë bankare;*
- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti;*
- *12 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Lidhur me numrin e zyrave zgjedhore

Nga monitorimi i bërë prej vëzhguesve të KRIIK rezultojnë 5 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Nga raportet e monitoruesve të KQZ-së rezultojnë 5 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Në raportin e vetëdeklarimit ky subjekt ka deklaruar 0 zyra zgjedhore të hapura për zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen koordinatat e vendndodhjes, brandimi ose jo me emër kandidati i zyrës zgjedhore, si dhe fotot përkatëse.

Vendndodhja	Bashkia	Partia	Kandidati/ja	Foto
40.4641563, 19.4898781	Vlorë	BD - Partia Bindja Demokratike	Ardi Kollozi	https://drive.google.com/file/d/1jus1KhsJ48AR-IEhLv8M7zRYbVrIhiru/view?usp=share_link
40.3261781, 19.4728732	Vlorë	BD - Partia Bindja Demokratike	Arsen Belaj	https://drive.google.com/file/d/1E7zeqjklwEINyZDCIWZbsEwULtqkFb/view?usp=share_link

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Vendndodhja	Bashkia	Partia	Kandidati/ja	Foto
40.6819328, 19.6230645	Patos	BD - Partia Bindja Demokratike	Stela Kerimi Skenderaj	https://drive.google.com/file/d/1avqHS3g5CCYXG0WemzyEfiW-Laox2pNY/view?usp=share_link
40.4484083, 19.4945912	Vlorë	BD - Partia Bindja Demokratike	Arjan Devollaj	https://drive.google.com/file/d/1tizvXxx2t-JKfoshnAlze9vPE0UVHBI/view?usp=share_link
40.534, 19.533	Vlorë	BD - Partia Bindja Demokratike	Arjan Devollaj	https://drive.google.com/file/d/1HQzeeA4Ridx7kiEO5v2JZxvZ7XqP0CR5/view?usp=share_link

Lidhur me pranime të dhurimeve mbi 50.000 lekë jo nëpërmjet llogarisë bankare

Partia Bindja Demokratike ka deklaruar 8 dhurues me shuma përkatësisht nga 100.000 lekë secili të kryera me para në dorë.

Lidhur me financierin njëkohësisht edhe kandidat

Referuar raportit të vetëdeklarimit dhe listës shumëemërore të kandidatëve të Partisë Bindja Demokratike, financieri z. Elon Ciko është edhe kandidat me numër rendor 24 në Qarkun Tiranë.

Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të BD për reklamë politike në Facebook dhe Instagram

Për 12 kandidatë të BD, sipas listës më poshtë rezulton se në faqet përkatëse në Facebook dhe Instagram janë paguar shuma të ndryshme për reklamë politike, por këta kandidatë nuk kanë dorëzuar një raport vetëdeklarimi në KQZ.

Për 4 kandidatë shuma e përlloritur e paguar është 1.033 lekë, pasi ajo nuk është fikse. Kjo pasi shpenzimet e bëra nën vlerën 100 USD nuk përcaktohen me saktësi, por me rang, duke e bërë të pamundur evidentimin e vlerës së saktë të shpenzuar. Në këtë rast për efekt përlloritjeje është marrë vlera minimale.

1. Arben Skënderaj ka paguar shumën 42,436 lekë.
2. Ardian Kollozi ka paguar shumën 41,403 lekë.
3. Astrit Patozi ka paguar shumën 205 lekë.
4. Bledar Burgjia ka paguar shumën 1,033 lekë.
5. Edison Hasanaj ka paguar shumën 1,033 lekë.
6. Erion Murataj ka paguar shumën 98,810 lekë.
7. Ilir Balla ka paguar shumën 1,033 lekë.
8. Mirela Oktrova ka paguar shumën 51,625 lekë.
9. Plarent Aleksis ka paguar shumën 1,033 lekë.
10. Roel Simaku ka paguar shumën 16,210 lekë.
11. Tonin Ulledaj ka paguar shumën 153,120 lekë.
12. Valbona Sakollari ka paguar shumën 33,143 lekë.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se BD nuk ka dorëzuar bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Me konsideratë,

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania